

VENDIM
Nr.553, datë 7.7.2010

PËR PËRCAKTIMIN E SEZONIT TË GJUETISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sezoni i gjuetisë, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, hapet më 1 tetor dhe mbyllet më 15 shkurt. Vetëm për llojet shkurtë (*Coturnix coturnix*) dhe turtull (*Streptopelia turtur*), sezoni hapet më 15 gusht, ndërsa për llojin rosë marsatore (*Anas querquedula*), sezoni mbyllet më 15 mars.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe drejtoritë përkatëse të Shërbimit Pyjor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha